



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1004/2prot.,

Datë 10.05.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-61393-03-06-2023, me objekt: “Blerje pajisje laboratorike për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave” me fond limit 8,999,233 (tetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë (pa TVSH), zhvilluar me datë 17.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

Ankimues: “Krijon” SHPK.
Rruga e Elbasanit , Nr. 57 Çollak, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara
Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë.

Në datën 09.05.2023, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1004 protokollit e operatorit ekonomik “Krijon” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-61393-03-06-2023, me objekt: “*Blerje pajisje laboratorike për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave*” me fond limit 8,999,233 (tetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë (pa TVSH), zhvilluar me datë 17.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Krijon” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “Krijon” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr 1004 prot.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 4, seksioni 2.3 Kapaciteti Teknik i Kriereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur katalog teknik të mallit per artikujt: “Pllake metalike drejtekendore” dhe “Pllake metalike rrethore”. Pas verifikimit të dokumentacionit të përcjellë në formë të shkruar nga ofertuesi “KRIJON” SH.P.K. me shkresen protokolluar me tonen Nr. 597 prot., date 24.04.2023, rezulton se, per keta artikuj Ofertuesi ka paraqitur vetem nje flete me emertimin “Oferte”, e cila nuk permban as elementet e nje oferte dhe as formen nje dokumenti te rregullt ligjor (firme dhe vule). Bazuar ne DST, te gjitha dokumentet duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara. Rastet e mosparaqitjes se nje dokumenti, ose dokumente false dhe te pasakta, konsiderohen kushte per skualifikim.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 10.05.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri